

**BASHKIA TIRANË
TIRANA PARKING
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. _____ Prot

Tiranë , më _____.____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

17.04.2025

Drejtuar: **INET**

Operatorit Ekonomik: INET Sh.p.k, me Numri Nipti K81607039F me adresë: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Ibrahim Rrugova, Sky Tower, Kati 3.

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Shërbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: “E Hapur”

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF -17555-08-30-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking”.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 21.02.2025

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit; Buletini Nr.9 datë 24 Shkurt 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “INSTANT.AL” shpk

L81506043D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **85,000,000** (tetëdhjetë e pesë milion) **Lekë Pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Advanced Business Solutions-ABS” shpk

K21710002J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **7,530,000** (shtatë milion e pesëqind e tridhjetë mijë) **Lekë Pa TVSH**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “3i-Solutions” shpk

L52305007S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **8,302,000** (tetë milion e treqind e dy mijë) **Lekë Pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “iCom”

L12402023H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. “INET” Shpk

K81607039F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **9,500,000** (nëntë milion e pesëqind mijë) **Lekë Pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. “BOE VODAFONE Sha K11715005L me adresë: Rruga Pavarësia 61, Kashar, Tiranë dhe 1UP LABS shpk M02102002A me adresë: Rruga Themistokli Gërmenji 1, Tiranë ”

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **9,260,000** (nëntë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) **Lekë Pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "INSTANT.AL" shpk

L81506043D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik "Instant.AL", në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ndër të tjera ka dorëzuar në sistemin elektronik (S.P.E) Formularin e Ofertës Ekonomike sipas Shtojcës 1 të DST, me çmim oferte 85,000,000 (tetëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH, të shprehur në shifra dhe fjalë.

Autoriteti Kontraktor konstaton se oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik është anomalisht e lartë, duke kaluar vlerën e fondit limit me 750%. Kjo e vendos ofertën jashtë parametrave të pranueshëm të buxhetit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Në zbatim të dispozitave ligjore, konkretisht pika 2 e Neni 91 të Ligjit 'Për Prokurimin Publik', ku ndalohet modifikimi i ofertave pas dorëzimit të tyre. *Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*

Ligji Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, vendos kufizime për të siguruar transparencë dhe barazi midis ofertuesve, duke mbrojtur procesin nga çdo përpjekje për të ndryshuar kushtet e ofertave pas afatit të përcaktuar. Për më tepër, në përputhje me Nenin 82 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, 'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', një ofertë nuk mund të konsiderohet e korigjueshme nëse çmimi i saj e kalon më shumë se 2% vlerën e fondit limit të ofruar.

Oferta juaj e kalon ndjeshëm fondin limit, si në këtë rast me një tejkalim prej 750%, jo vetëm që bie ndesh me rregullat ligjore të prokurimit publik, por gjithashtu krijon një disavantazh të padrejtë për pjesëmarrësit e tjerë në tender. Si rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor është i detyruar të vendosë moskualifikimin e ofertës në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Advanced Business Solutions-ABS” shpk

K21710002J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme:

I. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

d.një punonjës i certifikuar si profesionist i sigurisë së sistemeve të informacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Çertifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Në përmbushje të pikës (d) të kriterit 2.2.3 të Kapaciteti Teknik operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k, ka paraqitur:

-Dokumentin e përkthyer dhe njëzuar me origjinalin, me titull Check Point Certified Security Expert (CCSE) R81- Ekspert i certifikuar i sigurisë i pikës së kontrollit R81, për punonjësin Glenit Idirizaj, lëshuar nga furnizuesi Check Point.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit të saktësisë së dokumentit të paraqitur Certificate me titull Check Point Certified Security Expert (CCSE) R81- Ekspert i certifikuar i sigurisë i pikës së kontrollit R81 paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS sh.p.k, arrijmë në konkluzionin që Certifikata Check Point Certified Security Expert (CCSE) R81- Ekspert i certifikuar i sigurisë i pikave të kontrollit R81, nuk është e barazvlefshme dhe nuk mbulon ekspertizë ekuivalente, me certifikatën profesionist i certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit. Certifikimi CCSE R81 dëshmon që i certifikuari është specializuar për produktet e furnizuesit “Check Point” dhe dëshmon se i certifikuari zotëron njohuri në zgjidhjet e sigurisë të Check Point, përfshirë menaxhimin e firewall-eve dhe VPN-ve, duke përdorur platformën R81 të Check Point. Ky certifikimin është i përshtatshëm për profesionistët e sigurisë së rrjeteve që

punojnë ose planifikojnë të punojnë me produktet e Check Point. Ndërkohë, certifikata e sigurisë së sistemeve të informacionit në nivel profesionisti është një certifikim gjithëpërfshirës dhe i pavarur nga furnizuesit dhe i dëshmon Autoritetit Kontraktor (AK) se eksperti ose specialisti i punësuar nga OE garanton që OE është i aftë të identifikojë dhe zgjidhë problemet e mundshme të sigurisë që mund të shkaktojnë humbje të të dhënave, të integrojë modulet e reja në platformën ekzistuese pa rrezikuar sigurinë e sistemeve, dhe të zbatojë politika të sigurisë së informacionit, përfshirë kriptografinë, arkitekturën e sigurisë, sigurinë në zhvillimin e softuerit dhe kontrollin e aksesit.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

II. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

f.një punonjës të certifikuar si auditues i sistemeve të informacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Çertifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Në përmbushje të pikës (f) të kriterit 2.2.3 të Kapaciteti Teknik, operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS sh.p.k, ka paraqitur në sistemin e prokurimit publik (SPE):

-Certifikatë Trajnimi, me nr. AQS/T /S129702024, për pjesëmarrje në trajnimin me temë “Auditor/ Lead Auditor” sipas “Standartit ISO/IEC 27001:2022” Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatesise -Sistemet e menaxhimit te sigurise se informacionit – Kërkesat, të punonjësës Vanjela Pine.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, certifikata e trajnimit për pjesëmarrje në trajnimin “Auditor/Lead Auditor” sipas standardit ISO/IEC 27001:2022 nuk mund të konsiderohet ekuivalente me certifikatën e specializuar për auditimin e sistemeve të informacionit. Certifikata ISO/IEC 27001:2022 Auditor/Lead Auditor përqendrohet në trajnimin e pjesëmarrësve për të

audituar sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me kërkesat specifike të këtij standardi. Ndërkohë, certifikata e mbrojtjes (testimit) për auditimin e sistemeve të informacionit është një certifikim më i avancuar dhe i specializuar që dëshmon aftësitë e individëve për të kryer auditime gjithëpërfshirëse të sistemeve të informacionit. Ky certifikim mbulon njohuri të thelluara në auditimin e sigurisë, duke përfshirë arkitekturën e instalimit, gjurmimin e veprimeve gjatë fazave të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemit.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

III. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

c. një ekspert i certifikuar në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Në lidhje me përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.3 (c) të Kapacitetit Teknik të DST, operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS sh.p.k, ka paraqitur në sistemin e prokurimit publik (SPE):

-Dokumentin e përkthyer dhe njësuar me origjinalin, certifikatë me nr. GR448000014EM dhe me titull “Certified Associate Business Analyst (CABA)”- Analist i certifikuar i asociuar i biznesit (CABA), për punonjësen Eva Mecka.

-Dokumentin e përkthyer me titull “Bachelor në Administrim Bisnesi, në analitikë Bisnesi lëshuar nga Shkolla Ndërkombëtare e Biznesit Hult, për Fatona Shasivari.

Nga verifikimi i përputhjes së certifikatës në site zyrtar me kriterin e kërkuar, rezulton se certifikata me numër dhe titull “Certified Associate Business Analyst (CABA)” – Analist i Certifikuar i Asociuar i Biznesit (CABA), është një certifikim i nivelit fillestar që mbulon konceptet bazë të analizës së biznesit dhe nuk përfaqëson nivelin e eksperti, siç është kërkuar. Ndërkohë, në pikën (c) të kriterit 2.3.3, certifikimi në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës

është kërkuar të jetë në nivel eksperti për ti krijuar besueshmëri AK që O.E ka pjesë të sfatit të tij ekspert me njohuri të avancuara për zgjidhje teknike, të përqendruara në administrimin e bazave të të dhënave, analizën e të dhënave, BI (Business Intelligence) dhe zgjidhjet e menaxhimit të të dhënave.

Në lidhje me paraqitjen e dokumentit të përkthyer dhe të njësuar me origjinalin nga noteria publike, me titullin “Bachelor në Administrim Biznesi, në analizë Biznesi” të lëshuar nga Shkolla Ndërkombëtare e Biznesit Hult për Fationa Shasivari, sjellim në vëmendje dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky ligj përcakton qartë se institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar të diplomave dhe gradave shkencore në Republikën e Shqipërisë është ministria përgjegjëse për arsimin.

Dokumenti i përkthyer dhe i njësuar me origjinalin nga noterja publike, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, vërteton se kopjet dhe shkurtimet janë njësoj me origjinalin. Megjithatë, por nuk përfshin njohjen apo verifikimin e programit të studimit, por vetëm autenticitetin e dokumentit në aspektin formal. Në referim të ligjit për arsimin e lartë, vetëm diplomat e regjistruara në regjistrin shtetëror të diplomave do të konsiderohen të njohura dhe do të përbëjnë akte zyrtare për të gjitha autoritetet që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kjo do të thotë se diplomat që nuk janë të njësuar dhe të regjistruara në këtë regjistrë nuk mund të njihen zyrtarisht nga institucionet dhe autoritetet publike në vend, sipas legjislacionit në fuqi.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Në përfundim, komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se Operatori Ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 (c), (d), (f) të kapacitetit teknik, që është pjesë e Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “3-iSolutions” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

arsyet e mëposhtme:

L52305007S

Numri i NIPT-t

I. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.2.2., pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” ka kërkuar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik “3I SOLUTIONS” sh.p.k në sistemin e prokurimit publik (SPE), për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, ka paraqitur si vijon:

- Pasqyrën Financiare të Vitit 2023, të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
- Dokumentin Pasqyrë Financiare të Vitit 2022, të pa konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
- Dokumentin Pasqyrë Financiare të Vitit 2021, të pa konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur Pasqyr Financiare për Vitin ushtrimor 2022 dhe Pasqyrë Financiare për Vitin ushtrimor 2021, rezulton se O.E ka dorëzuar PF të pa konfirmuara nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë) sikurse përcaktuar në pikën 2.2.2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar. Autoriteti Kontraktor e vlerëson ofertën tuaj në parim të procesit të përzgjedhjes në zbatim pikës 1(a) dhe (b) dhe 3 të Nenit 80 dhe Nenit 70 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar. Dokumentat provuese të paraqitura (PF për Vitin ushtrimor 2022 dhe PF për Vitin ushtrimor 2021), nuk përmbushin kërkesat kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim.

II. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë:

f.një punonjës të çertifikuar si auditues i sistemeve të informacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Në përmbushje të pikës (a) të kriterit 2.2.3 të Kapaciteti Teknik operatori ekonomik “3I SOLUTIONS” sh.p.k, ka paraqitur:

- Dokumentin në gjuhën angleze me titull CISA-Certified Information System Auditor lëshuar nga Ofruesi i kurseve online Udemy.com, për ndjekjen e 8 orëve online nga punojësi Qerim Lloshi.
- Dokumentin e përkthyer dhe njësuar me origjinalin, me titull Certified Information System Auditor lëshuar nga trupi certifikues ISACA për të certifikuarin Ervis (Angjelin) Smakaj, me numër certifikate M018170284CR.


Pas shqyrtimit dhe verifikimit të saktësisë së dokumentit të paraqitur në gjuhën angleze “Certificate of Completion” paraqitur nga operatori ekonomik “3I SOLUTIONS” sh.p.k, rezulton se lëshuesi i kësaj certifikate, (*Education Site*) “*UDEMY*”, nuk është trup certifikues i akredituar por web-site online që ofron kurse të fushave të ndryshme. Ofruesi i kurseve online Udemy.com nuk është një institucion i akredituar për certifikim, prandaj dokumenti i përfituar nga Udemy për ndjekjen e një kursi online prej 8 orësh nuk është i pajtueshëm apo i barazvlefshëm me standardet e kërkuara të cilësisë të certifikatës për auditimin e sistemeve të informacionit (CISA). Certifikimi CISA është një certifikim zyrtar i lëshuar nga trupi certifikues i akredituar ISACA (Information Systems Audit and Control Association) dhe ofrohet për kandidatët që duhet të kalojnë një testim rigoroz, ndërkohë që site i Udemy ofron kurse online që përfshijnë përgatitje për provimin për certifikim CISA, por nuk është trup certifikues zyrtar dhe i akredituar.

Duke u nisur nga ky fakt, nuk krijohet besimi për aftësitë e punonjësit të pajisur me këtë lloj certifikate, dhe për më tepër, nuk ofrohet garancia e nevojshme për përmbushjen e kriterit të përmendur më sipër, duke sjellë një rrezik të konsiderueshëm për ecurinë e projektit/kontratës dhe investimin në tërësi. Megjithëse “UDEMY” funksionon si një platformë për mësimin online, duke qenë e paakredituar për të ofruar certifikime zyrtare, çdo person mund të certifikohet në fusha të caktuara përmes kurseve me video të disponueshme dhe ky fakt kjo nuk ofron besueshmëri të mjaftueshme për Autoritetin Kontraktor. Përveç kësaj, dokumenti është dorëzuar në gjuhën angleze, çka bie në kundërshtim me pikën 4.7 të DST, ku gjuha shqipe është përcaktuar si gjuha e detyrueshme për hartimin e ofertave.

Gjithashtu, pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumentit të përkthyer dhe të krahasuar me origjinalin, me titullin “Certified Information System Auditor” lëshuar nga trupi certifikues

CRISC për të certifikuarin Ervis (Angjelin) Smakaj, me numër certifikate M018170284CR, u konstatua se dokumenti i paraqitur përmban disa mangësi. Arrijmë në përfundimin që dokumenti i paraqitur nuk vërteton pajtueshmërinë dhe autenticitetin e certifikimit Auditor i Certifikuar i Sistemeve të Informacionit (CRISC/CISA). Ky certifikim lëshohet ekskluzivisht nga ISACA (Shoqata Ndërkombëtare e Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit) dhe nuk ka asnjë institucion të akredituar ose të licencuar në Republikën e Shqipërisë për njohjen ose lëshimin e certifikimit CISA. Certifikimi është i lëshuar nga ISACA dhe mund të verifikohet përmes faqes zyrtare: <https://www.isaca.org/credentialing/verify-a-certification>.

Pas verifikimit të certifikatës me numër M018170284CR në faqen zyrtare, rezulton se ky dokument nuk ekziston. Mosparaqitja e dokumentit ose paraqitja e dokumenteve të rreme apo të pasakta konsiderohet një arsye për skualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.



Confirm your address and profile details to support your 2025 renewal process! Please visit [MyISACA](#) to access your profile.

ISACA

SEARCH

JOIN/RENEW ABOUT US CAREERS SUPPORT STORE SIGN IN

CREDENTIALING MEMBERSHIP ENTERPRISE PARTNERSHIPS TRAINING & EVENTS RESOURCES


Verify a Certification

Select the type of certification, enter the certificate number that they would have provided you with, and their last name exactly as it appears in their ISACA profile.

You can also submit verification requests along with a signed written consent from the individual to our [Customer Experience Center](#).

Could not find a certification matching the following:
Certification Type: CRISC
Certification Number: 018170284
Last Name: Smakaj

TRY AGAIN PRINT RESULT



III. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

d.një punonjës i certifikuar si profesionist i sigurisë së sistemeve të informacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Në përmbushje të pikës (d) të kriterit 2.2.3 të Kapaciteti Teknik operatori ekonomik “3I SOLUTIONS” sh.p.k, ka paraqitur:

- Dokumentin e përkthyer dhe njëzuar me origjinalin, me titull Certified Information System Security Profesional (CISP) lëshuar nga trupi certifikues ISC2 për të certifikuarën Alma (lvzi) Shehu, me numër cerifikate M0181702895A.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur për certifikatën "Certified Information System Security Profesional - Profesionist i certifikuar për sigurinë e sistemit të informacionit (CISP)" dhe pas verifikimit të vlefshmërisë së dokumentit në faqen zyrtare të lëshuesit, ISC2 (International Information System Security Certification Consortium), përmes linkut

<https://my.isc2.org/s/MemberVerification>, nuk u gjet asnjë regjistrim për certifikatën CISP me numrin M0181702895A, e paraqitur nga O.E për punonjësën Alma Shehu. Certifikata nuk përmbush kriteret e vlefshmërisë dhe nuk siguron përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga AK për këtë kriter.

Certified Information System Security Professional (CISSP) - Profesionisti i çertifikuar për sigurinë e sistemit të informacionit ofrohet ekskluzivisht nga Konsorciumi Ndërkombëtar për Certifikimin e Sigurisë së Sistemit të Informacionit (ISC)², e cila është e vetmja organizatë e akredituar dhe e autorizuar për të lëshuar dhe menaxhuar certifikimin CISSP.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

The screenshot shows the ISC2 Member Verification interface. On the left, under 'Search Records', there are two input fields. The first is 'Last Name' with the value 'Shehi' and a green checkmark icon. The second is 'ISC ID Number' with the value 'M0181702895A' and a green checkmark icon. Below these fields is a blue 'Search' button. On the right, a box indicates 'No records found'.

IV. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale mbrojtjeje, si më poshtë:

- a. një punonjës të certifikuar si specialist në programimin në HTML5 me JavaScript dhe CSS3 ose ekuivalente.
- b. dy punonjës të certifikuar si zhvillues të Java SE/ PHP ose ekuivalente.
- c. një ekspert i certifikuar në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës.
- d. dy punonjës të certifikuar si specialist të zgjidhjes Windows Server 2016 ose ekuivalente.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës, Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Operatori ekonomik “3I SOLUTIONS” sh.p.k, ka paraqitur nëpërmjet SPE:

- Certifikatën në gjuhën angleze me titull HTML 5 Test, CSS 3 Test, JavaScript 1.8 Test, lëshuar nga Ofruesi i certifikimeve online ExpertRating, për punojësin Qerim Lloshi.
- Certifikatën në gjuhën angleze me titull Java 8 Programming Skills Test, lëshuar nga Ofruesi i certifikimeve online ExpertRating, për punojësin Hane Marku.
- Certifikatën në gjuhën angleze me titull Windows Server 2016 Skills Test, lëshuar nga Ofruesi i certifikimeve online ExpertRating, për punojësin Josela Lesi.
- Certifikatën në gjuhën angleze me titull Windows Server 2016 Skills Test, lëshuar nga Ofruesi i certifikimeve online ExpertRating, për punojësin Fabio Mici.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimi në faqet ndërkombëtare, rezulton se lëshuesi i këtyre certifikatave, “ExpertRating”, nuk është një certifikues i akredituar nga asnjë prej organeve kryesore ndërkombëtare akredituese, si ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim), ANSI (Instituti Kombëtar Amerikan i Standardeve), DEAC (Komisioni i Akreditimit të Arsimit në Distançë), etj. ExpertRating është një platformë online që ofron një sërë certifikimesh në fusha të ndryshme, si programimi, fitnesi, biznesi dhe të tjera, por certifikatat e saj janë përgjithësisht të konsideruara si plotësuese dhe nuk përmbushin standardet e institucioneve të akredituara si Oracle, Microsoft, Cisco, ISC², ISACA, etj.

Duke pasur parasysh këtë fakt, nuk mund të krijohet besimi i plotë në aftësitë e specialistëve që mbajnë këto certifikata, pasi ato janë të fokusuara kryesisht në njohuri bazë dhe kurse hyrëse. Për një projekt kompleks siç është digjitalizimi i shërbimeve të reja të platformës Tirana Parking, kërkohet ekspertizë e avancuar dhe përvojë e gjerë në zhvillimin e softuerit dhe implementimin e sistemeve digjitale me standarde të larta. Certifikatat që nuk përfshijnë trajnim të thelluar dhe nuk demonstrojnë përvojë praktike të avancuar nuk ofrojnë sigurinë e nevojshme për një projekt të kësaj madhësie, duke sjellë një rrezik të madh për ecurinë e përgjithshme të projektit ose kontratës.

Kjo nuk krijon besueshmëri të mjaftueshme për punëdhënësit në përgjithësi, e aq më pak për Autoritetin Kontraktor, i cili po investon në një projekt të rëndësishëm si “Digjitalizimi i

shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi përmes platformës "Tirana Parking". Gjithashtu, dokumentacioni është paraqitur është vetëm në gjuhën angleze, në kundërshtim me pikën 4.7 të DST-së, ku gjuha shqipe është përcaktuar si gjuha e hartimit të ofertave.

Në përfundim, komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se Operatori Ekonomik "3I Solutions" sh.p.k, nuk ka përmbushur plotësisht kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.2 dhe pikën 2.3.3 (a), (b-1 punonjës), (d), (e), (f) të kapacitetit teknik, pjesë e Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. "iCom"

L12402023H

Emri i plotë i shoqërisë
arsyet e mëposhtme:

Numri i NIPT-t

- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. "BOE VODAFONE Sha K11715005L dhe 1UP LABS shpk M02102002A"

Emri i plotë i shoqërisë
arsyet e mëposhtme:

Numri i NIPT-t

I. Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe Nenin 26 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të përditësuar në pikën 2 të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), ka kërkuar dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Anëtari i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (B.O.E) “1UP LABS” Sh.p.k., për të përmbushur këtë kriter, ka dorëzuar Deklaratën për Përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit, që përbën pjesë të formularit të vetëdeklarimit (shtojca 9). Megjithatë, në këtë deklaratë, nuk është përmendur statusi juridik i shtetasit z. Klaudian Dhefto, ortak/aksioner në “1UP LABS” Sh.p.k., nëse është ose jo i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprat penale të përcaktuara në pikën 1 të nenit 76 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Një situatë e ngjashme është vënë re edhe për partnerin tjetër të B.O.E., “Vodafone Albania” Sh.A. Në përmbushje të pikës a të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ky operator ka dorëzuar Deklaratën për Përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit, pjesë e formularit të vetëdeklarimit (shtojca 9). Megjithatë, nuk është deklaruar statusi juridik i aksionerëve kryesorë të “Vodafone Albania” Sh.A., përkatësisht z. Martin Buckers dhe znj. Sarah Clementine van der Loo, të cilët zotërojnë 100% të aksioneve në “Vodafone Europe B.V.” Sh.p.k pasqyruar shoqëri aksionere e vetme vendimarrëse në “Vodafone Albania” Sh.A, në Qendrën Kombetare të Bisnesit. Në Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk është deklaruar nëse këta individë janë dënuar ose jo me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së, apo nëse ka kaluar periudha 5-vjeçare nga ekzekutimi i ndonjë dënimi, përveç nëse një periudhë tjetër është përcaktuar nga gjykata, sipas nenit 76 të LPP-së.

Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të dorëzuar nga anëtari i B.O.E “1UP LABS” Sh.p.k dhe partneri “Vodafone Albania” Sh.A, duhet të përmbajnë informacion të saktë dhe të plotë për secilin individ që ka rolin e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, dhe që ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrëse apo kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Mungesa e informacionit të deklaruar bie ndesh me dispozitat e Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Mosplotësimi i këtyre kërkesave ligjore rezulton në moskualifikimin e bashkimit të operatorëve në këtë procedurë prokurimi.

II. Autoriteti Kontraktues në pikën 2.3.2, a) dhe b) të DST-së ka kërkuar:

a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.3 a) dhe b) të Kapacitetit Teknik të DST, anëtari i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, “1UP LABS” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a., ka paraqitur certifikatat e menaxhimit të cilësisë dhe të sigurisë së informacionit. Konkretisht, janë dorëzuar Çertifikata ISO 9001:2005 me numër I1659961028Q dhe Çertifikata ISO 27001:2022 me numër I1659961228I, të lëshuara nga institucioni certifikues King Cert International Certification Ltd.

Pas kryerjes së verifikimit të vlefshmërisë së këtyre certifikateve përmes faqes zyrtare të internetit të ofruar nga institucioni certifikues, në adresën <https://kingcert.com/sertifika-sorgula/en/>, është konstatuar

se certifikatat ISO 9001:2005 dhe ISO 27001:2022 të paraqitura nga “1UP LABS” sh.p.k janë të pavlefshme dhe të pezulluara.

Bazuar në këtë verifikim, konkludohet se “1UP LABS” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 a) dhe b) të DST-së, duke qenë se këto certifikatat e tyre nuk rezultojnë të vlefshme, nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për të garantuar kualifikimin dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara.

Pamja e ekranit (faqja 3) tregon rezultate të verifikimit nga faqja e internetit <https://kingcert.com/sertifika-sorgula/en/>.

III. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

b.dy punonjës të certifikuar si zhvillues të Java/ PHP ose ekuivalente.

d.një punonjës i certifikuar si profesionist i sigurisë së sistemeve të informacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kritereve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vëndi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV e secilit punonjës dhe Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Anëtari i B.O.E “1UP LABS” Sh.p.k në sistemin e prokurimit publik, për të vërtetuar përmbushjen e këtyre kritereve, ka paraqitur Deklaratën për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (Shtojca 9), ku deklarohet se nga pesë (5) punonjës të certifikuar në fushën e IT-së, dy (2) prej tyre do të angazhohen në këtë prokurim: Erald Kërlluku, i pajisur me Certifikatën Comptia Security+ dhe Microsoft Certified Azure Developer Associate, si dhe Jona Hysaj, e pajisur me Certifikatën Microsoft Certified Azure Developer Associate. Gjithashtu, anëtari i B.O.E ka paraqitur në SPE kopjet e noterizuara të certifikatave përkatëse: certifikatën me nr. 6AIC18-75FR65, e lëshuar nga Microsoft për Erald Kërllukun, dhe certifikata me nr. B13607-184DR8, e lëshuar nga Microsoft për Jona Hysaj.

Certifikata Azure Developer Associate përqendrohet në zhvillimin e aplikacioneve për mjedisin cloud dhe përdorimin e shërbimeve të platformës Azure për të menaxhuar aplikacionet e tyre. Pra, certifikimi Azure Developer Associate fokusohet në menaxhimin dhe zhvillimin në një platformë cloud dhe jo në një gjuhë specifike programimi. Ndërsa zhvilluesit e certifikuar në Java, PHP, ose gjuhë të ngjashme i garantojnë AK njohuri të thelluara dhe përvojë të avancuar në programimin backend, që është e rëndësishme për krijimin e moduleve të reja në platformën për metodat alternative të pagesave të parkimit. Zhvillimi i moduleve të reja për shërbimet e parkimit, si abonimet, shërbimet për rezidentët dhe taksitë, kërkon aftësi komplekse dhe një kuptim të avancuar të platformës ekzistuese, duke përfshirë integrimin e funksionaliteteve të reja pa shkaktuar ndërprerje ose probleme në sistem. Argumentojmë se lloji i certifikatës Microsoft Certified: Azure Developer Associate nuk është i barazvlefshëm apo ekuivalent me certifikimet në gjuhë programimi si Java apo PHP. Certifikimet në Java dhe PHP fokusohen zhvillimin e aplikacioneve duke përdorur ato gjuhë specifike dhe sigurojnë kodim të saktë dhe të optimizuar.

Për të vërtetuar përmbushjen e pikws d., Anëtari i B.O.E “1UP LABS” Sh.p.k, ka paraqitur në SPE:

Certifikatën Comptia Security+, me kod verifikimi S4QDW6CQMFF41P9S, lëshuar për Erald Kërllukun.

Nga verifikimi i përputhjes së certifikatës me kriterin e kërkuar rezulton se CompTIA Security+ është një certifikim i nivelit fillestar që ofron kuptim themelor të koncepteve kryesore të sigurisë dhe mbulon tema të tilla si siguria e rrjetit, kërcënimet, dobësitë, menaxhimi i identitetit dhe kontrolli i aksesit. Ky certifikim është për individët që sapo kanë filluar karrierën e tyre në sigurinë kibernetike që kërkojnë të vërtetojnë aftësitë bazë të sigurisë. Ndërkohë që, certifikata për Siguria e Sistemeve të Informacionit, në nivel profesionisti është një certifikim i nivelit të avancuar e ofruar për profesionistë me përvojë të sigurisë dhe mbulon gjerësisht fusha si krijimi dhe implementimi (arkitektura e sigurisë) i politikave të sigurisë së informacionit, kontrolli i aksesit, kriptografia, menaxhimi i sulmeve të mundshme etj. Certifikimi në nivel profesionisti i ofron garanci për Autoritetin Kontraktor (AK) se OE ka në stafin e tij punonjësi është i kualifikuar për të hartuar dhe zbatuar politika të ndryshme të sigurisë, përfshirë politikat e aksesit të të dhënave, politikat e kontrollit të versionit dhe politikat e sigurisë dhe mirëmbajtjes së të dhënave. Në referim të argumentimit të mësipërm, vlerësojmë se certifikata CompTIA Security+ nuk është e barasvlefshme me certifikimin e kërkuar dhe nuk siguron përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në kriterin e përmendur nga Autoriteti Kontraktor (AK).

IV.Partneri i B.O.E “Vodafone Albania” Sh.A, në përmbushje të kërkesave sipas pikës 2.3.3 të Kapacitetit Teknik të DST, ka dorëzuar në SPE deklaratën për disponueshmërinë e punonjësve dhe pajisjeve të nevojshme (Shtojca 9), ku është deklaruar se 10 punonjës, me emrat përkatës do të angazhohen në këtë prokurim por deklarata nuk përmban detaje të mjaftueshme për rolet specifike/profilin profesional apo/dhe certifikimet përkatëse të këtyre punonjësve, duke e bërë kështu informacionin e paraqitur në formularin e vetëdeklarimit të paplotë.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit të saktësisë së dokumentit të paraqitur në gjuhën angleze “Certificate of Completion” paraqitur nga anëtori i B.O.E “Vodafone Albania” Sh.A, lëshuar nga Ofruesi i kurseve online Udemy.com, për përmbushjen e 5 orëve online të CompTIA IT Fundamentals nga punonjësi Arian Kapllanaj në site online, rezulton se lëshuesi i kësaj certifikate, (Education Site) “UDEMY”, nuk është certifikues i akredituar.

Ndodhur, para këtij fakti nuk krijohet bindja për aftësitë e specialistëve të pajisur me këtë tip certifikate, dhe për më tepër nuk sigurohet garancia e kërkuar në përmbushje të kriterit si më sipërcituar, duke sjellë një risk të konsiderueshëm në mbarëvajtjen e projektit/kontratës dhe investimit në tërësi. Pavarësisht se “UDEMY” shërben si një platformë për mësimin online, duke qënë i paakredituar për të certifikuar, çdokush mund të certifikohet në fusha të caktuara për të cilën ofrohen video online të kursit të ofruar, por nuk krijon besueshmëri për punëdhënësit në përgjithësi dhe për më tepër për AK.

Ofruesi i kurseve online Udemy.com nuk është një institucion i akredituar për certifikim, prandaj certifikata e marrë nga Udemy për ndjekjen e një kursi online prej 5 orësh nuk është e barasvlefshme me certifikatën në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe nuk vërteton aftësitë profesionale për asnjë nga specialistët e kërkuar në pikën 2.3.3 të DST. Për më tepër, dokumenti është paraqitur në gjuhën angleze, gjë që bie në kundërshtim me pikën 4.7 të DST, ku gjuha shqipe është përcaktuar si gjuha e kërkuar për hartimin e ofertave.

V.Anëtori i B.O.E “Vodafone Albania” Sh.A, pwrvec dokumentit tw mwsipwrm ka dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik (SPE) 9 certifikata kurseve në gjuhën angleze, për përfundimin e kurseve me përmbajtje teorike në gjuhët e programimit C++, C#, CSS, HTML, Java, JavaScript, PHP, Python për Fillestarë, dhe SQL, për punonjësin Arian Kapllanaj, lëshuar nga ofruesi i kurseve “Sololearn”.Nisur nga

informacioni i ofruar dhe verifikimi në faqen zyrtare të lëshuesit të certifikatave www.sololearn.com, rezulton se “aktualisht, certifikatat e Sololearn nuk janë të akredituara zyrtarisht nga asnjë organ i industrisë”. Certifikatat e përfituara nga platforma të tilla si Sololearn, megjithëse ndihmojnë në vetë-edukim, nuk përmbushin standardet e kërkuara nga AK dhe nuk dëshmojnë kompetencat profesionale për punonjësit.

AK me verifikimin e faktit të sipërpërmendur, arrijmë në përfundimin se këto certifikata kursi nuk plotësojnë kërkesën e pikës 2.3.3 të DST, e cila përcakton se, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikata ose transkripte të vlefshme të lëshuara nga subjekte të akredituara, qoftë nga vendi i origjinës ose nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar.

VI.Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik në dokumentet standarde të tenderit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar që, për të vërtetuar disponimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore profesionale për realizimin e projektit brenda afateve dhe sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar:

e.dy punonjës të certifikuar si specialist të zgjidhjes Windows Server 2016 ose ekuivalente.

g. një punonjës i certifikuar si profesionist i sigurisë së sistemeve të informacionit, të siguar për 3 (tre) muajt e fundit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga vendi i origjinës ose/dhe nga Republika e Shqipërisë, për secilin punonjës të kualifikuar, CV dhe Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Anëtar i B.O.E “Vodafone Albania” Sh.A ka paraqitur dokumentin në gjuhën angleze “Certificate of Acknowledge” në emër të punonjësit Dritan Ulqinaku, për Information Technology Security Fundamentals , me datë 14 Maj 2015, lëshuar nga “Brainbench”, një kompani e njohur si Previsor, me ID transkripti: 12702339, për verifikim në faqen e internetit www.brainbench.com. Nga verifikimi i përputhshmërisë së certifikatës me kriterin e kërkuar nëpërmjet site-it online, rezulton se kjo faqe nuk është më aktive dhe nuk ofron më shërbime certifikimi. Certifikatat e lëshuara nga Brainbench janë të vlefshme për tre (3) vjet nga data e përfundimit të testit, kështu që certifikata e paraqitur ka qenë e vlefshme deri më 14 Maj 2018. Për më tepër, lloji i certifikimit me titull “Bazat e Sigurisë së Teknologjisë së Informacionit” është një certifikatë e nivelit fillestar që fokusohet në konceptet themelore të sigurisë. Ajo ofron një kuptim bazë të parimeve të sigurisë në teknologjinë e informacionit, por nuk është projektuar për profesionistët e avancuar ndërkohë që, certifikata e kërkuar e sigurisë së sistemeve të informacionit në nivel profesionisti është një certifikatë e nivelit të avancuar e përshtatur për profesionistë që kanë njohuri dhe eksperiencë më të gjërë në arkitekturën e sigurisë, kriptografinë, menaxhimin e rrezikut, kontrollin e aksesit dhe implementimi të politikave të sigurisë. Në argumentim të sa mësipër gjykojmë se dokumenti në gjuhën angleze “Certificate of Acknowledge” është e pavlefshme dhe nuk është ekuivalente e certifikimit të kërkuar dhe nuk siguron përmbushjen e kërkesave të kriterit të sipërpërmendur nga AK. Përveç kësaj, dokumenti është paraqitur në gjuhën angleze, në kundërshtim me pikën 4.7 të DST-së, ku gjuha shqipe është përcaktuar si gjuha e hartimit të ofertave.

Gjithashtu, anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “1UP LABS” Sh.p.k. dhe “Vodafone Albania” Sh.A, nuk kanë vërtetuar përmbushjen e pikës (e) të kriterit 2.3.3 të Kapacitetit Teknik , pasi në deklaratat e paraqitura për disponueshmërinë e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (Formulet Përmbledhëse të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9), nuk kanë specifikuar se cilët nga punonjësit janë të certifikuar si specialistë për zgjidhjet Windows Server 2016 ose ekuivalente. Gjithashtu, në SPE nuk kanë dorëzuar asnjë certifikatë përkatëse dhe/ose ekuivalente për përmbushjen e këtij kriteri. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kusht për skualifikim.

Në përfundim, KVO konstaton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “1UP LABS” Sh.p.k dhe “Vodafone Albania” Sh.A, ndër të tjera, nuk ka përmbushur kriterin 2.2.2 (a), (b) dhe kriterin 2.3.3 (a), (b-1 punonjës), (d), (e), (g) të kapacitetit teknik, pjesë e Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“INET” sh.p.k** me adresë: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 3. se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9,500,000** (nëntë milion e pesëqind mijë) **Lekë Pa TVSH** është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, Adresa: Rruga “Ali Begeja”, Ndërtesa 16, Kodi Postar 1017 Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax +355 4 221111 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☒ JO ☐

Nëse Po (Nr.467/2025 Datë 09.04.2025 i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Flavio Barçi

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR, DREJTORIA JURIDIKE**

Sindi Hatillari